



		VAJZA					USHQIMI					REKUIZITA				
		Anita	Selvia	Tina	Liđia	Ana	Fruta	Mish	Gjevrek	Biskota	Sallatë	Top	Dylbi	Badminton	Letra	Frizbi
PARTNERI	Artani															
	Festimi															
	Berati															
	Petriti															
	Fitimi															
REKUIZITA	Top															
	Dylbi															
	Badminton															
	Letra															
	Frizbi															
USHQIMI	Fruta															
	Mish															
	Gjevrek															
	Biskota															
	Sallatë															

Një ditë me diell, pesë çifte nga Gjmnazi dolën në piknik në natyrë. Secili çift solli me vete gjëra për të ngrënë (gjevrekë, mish të pjekur në skarë, sallatë, fruta dhe biskota) si dhe rekuizita për argëtim (frizbi, dylbi, letra, top dhe badminton). Gjeni cilët janë ato çifte dhe çfarë sollën me vete në piknik.

Të dhënat:

1. Njëri çift përbëhet nga Tina dhe Fitimi.
2. Anita dhe partneri i saj (i cili nuk është Petriti) sollën letra, ndërsa dikush tjetër biskota dhe frizbi.
3. Njëri çift solli sallatë dhe badminton, ndërsa tjetri top dhe mish të pjekur në skarë.
4. Selvia dhe partneri i saj patën një qese të madhe frutash.
5. Partneri i Anës solli frizbi.
6. Liđia dhe partneri i saj nuk sollën sallatë.
7. Dylbitë i sollën Berati dhe e dashura e tij.
8. Artani dhe e dashura e tij (e cila s'është Liđia) sollën biskota.
9. Çifti që solli fruta i pru edhe dylbitë.
10. Gjevrekët dhe letrat i solli çifti i njëjtë.

TABELA

	VAJZA	USHQIMI	REKUIZITA
Fitimi			
Festimi			
Petriti			
Berati			
Artani			